

SENDET QË JU BEZDISIN?



NJË SHËRBIM FALAS PËR MBLEDHJEN E MBETURINAVE NËPËR SHTËPI, SIPAS THIRRJES

Përparësitë:

- Kujdesi i shpejtë për sendet, sidomos në rast të shpërnguljes;
- Një gamë e madhe sendesh të mbledhura (mobile, stoli, sanitari, dekorime...);
- Një zgjidhje alternative për njerëzit që nuk kanë makina ose që kanë lëvizshmëri të kufizuar;
- Një përmirësim i planit të jetës;
- Sende që do të ripërdoren ose që do të riciklohen

MODALITETET PRAKTIKE

Ressourcerie Namuroise ka mbledhur mbi 200 sende në gjendje të mirë ose jo të mirë: mobile, pajisje ndriçimi, sanitari, aparate elektrike shtëpiake, stof mobilesh, libra, stoli...

- Thërrisni Ressources Namuroise në numrin: 081/260.400.
- Një operator do t'ju caktojë datën e ardhjes së kamionit për mbledhjen e mbeturinave.
- Sendet tuaja mblidhen në katin përdhes të shtëpisë.
- Sasitë janë të kufizuara në 2m3 mbeturina për t'u larguar.
- Numri i largimit të sendeve që bezdisin është i kufizuar në parim në gjashtë herë në vit.

NJË JETË TJETËR PËR SENDET TUAJA

Pas një faze të klasifikimit, për çdo send të mbledhur bëhet një zgjidhje specifike.

- Materiali që vlerësohet ashtu siç është, rishitet i tillë çfarë është.
- Prodhimet që janë në gjendje të keqe por që ka mundësi të përdoren sërish kalojnë nëpër një fazë të renovimit.
- Disa sende rishikohen nga një ekip artistësh.
- Sendet ose materialet që nuk hyjnë në këto kategori, shkatërrohen dhe dërgohen në procesin e riciklitimit më adekuat: druri, metali...
- Përfundimisht, 20 % të prodhimeve të mbledhura ripërdoren, 60 % riciklohen kurse vetëm 20 % e tyre përfaqësojnë mbeturinat përfundimtare që do të largohen.

PËR TË DITUR MË SHUMË SHIH:

www.environnement-namur.be

LARGIMI I MBETURINAVE ORGANIKE

Materiet organike paraqesin përafërsisht 30 % të prodhimit tonë të mbeturinave. Bëhet fjalë kryesisht për mbeturinat e kuzhinës dhe për mbeturinat e kopshtit. Klasifikimi i tyre do të thotë zvogëlim i vëllimit të mbeturinave tuaja.



**Janë dy zgjidhje:
Plehrimi individual ose mbledhja prej
dere në derë e materieve organike**

Nëse keni kopsht, madje edhe të vogël, mendoni për plehërimin individual. Plehu i prodhuar do t'i përmirësojë lehtë tuaja. Fjala është për teknikën sa më ambientale të largimit të mbeturinave dhe më pak të kushtueshme.

Përndryshe, klasifikoni mbeturinat tuaja dhe merrni pjesë në mbledhjen nga dera në derë të materieve organike. Kjo mbledhje organizohet në të njëjtën kohë me atë të mbeturive shtëpiake.

MODALITETET PRAKTIKE

■ Plehërimi individual

Ekzistojnë shumë mënyra plehrimi: në grumbull plehrash, në silos, ose me anë të plehrave të ngjeshura. Qyteti ju propozon ta bleni një kompostierë individuale me kushte interesante. Për çdo informatë, kontaktoni numrin: 0800/935.62

Çka të depononi në kompostierën tuaj?

- Mbeturinat tuaja ushqimore pa ambalazh: mbetjet e shujtave, mishin, peshkun, pemët, perimet, gëzhhojat e vezëve, të arrave, të gocave të detit, të guacave, ushqimet e prishura;
- Fletë dhe qese çaji, filtra dhe fundaq kafeje;
- Faculeta dhe salveta letre, pastruese enësh;
- Mbeturinat e gjelbra të kopshtit dhe të brendshme; lule, bimë, perime, mbeturina nga bari i kositur, dhe nga krasitja e gardheve.
- Plehu, kashta, ashkla dhe cifla druri, hi druri;

■ Mbledhja derë më derë e materieve organike

Mbeturinat organike duhet të deponohen në thasë bërllogu të biodegradueshëm. Ju mund t'i paktoni në thasë më të vegjël të biodegradueshëm, në letra pastrimi, në letra gazetash ose në ambalazh buke, por asesi në thasë plastikë.

Çka duhet të depononi në thasë të rregullt mbeturinash?

- Të gjitha mbeturinat të cilat ju mund t'i depononi në kompostierën tuaj;
- Ndrizat e fëmijëve (jo ndrizat e të rriturve)

PARQET ME KONTEJNERË PËR T'I PRANUAR MBETURINAT TUAJA



PARQET ME KONTEJNERË JANË VENDE KU MUND TË SILLNIMBETURINA TË NDRYSHME PËR T'I DEPONUAR NË KONTEJNERË SPECIFIKË

Në Namur janë tri parqe me kontejnerë :

- Malonne - chemin de la Vieille Sambre 87
- Nannine - chemin de Malpaire
- Champion - chemin de Boninne

Të hapur nga e hëna deri të premten prej ores 9 deri 18⁰⁰
të shtuneve prej ores 9 deri 17⁰⁰

ÇFARË TË DEPONONI NË PARKUN ME KONTEJNERË?

- **Sendet** që ju pengojnë (maksimumi 1m³ në ditë): mbeturinat tepër voluminoze për t'i futur në thasë mbeturinash të madhësisë 60 L (dyshekë, tepih, kolltuqe, korniza me ose pa xhama, letra dekoruese)...;
- **Dru** ose objekte të ndërtuara së paku 80 % nga druri;
- **Metalet** : shtretër metalikë, shporetë me gaz, nxemëse uji me gaz, tinarë, biçikleta...;
- **Mbaturinat tuaja të pajisjeve elektrike ose elektronike (MPEE)** : Kompjuterë, GMS, pajisje elektrike shtëpiake...;
- Mbaturinat tuaja inerte (maksimumi 1m³ në ditë): lëmishte, tulla, allçi, gurë, dhe...;
- **Mbaturina të gjelbra** : degëza, mbaturina nga bari i kositur, gjethe dhe mbaturinat nga krasitja e gardheve...;
- **Kapakë dhe tapa** pa ngjitës;
- **Fishekë ngjyrash** të zbrazët të printerëve dhe të fakseve;
- **Letrat dhe kartonët** e shpalosur, të pastër, pa plastikë dhe pa kapëse dhe trombonët
- **Bateritë** tuaja;
- **Mbaturinat tuaja speciale** : ngjyrat, llaqet, prodhimet e rreziks hme, plehrat artificiale, bateritë e makinave, aparatet për shuarje të zjarrit, gypat e neonit, termometrat me zhivë, negativët e rentgenit, prodhimet për fotografi, seringat e future në ambalazhe të forta plastike dhe të mbyllur...;
- **Filmat** tuaj dhe qeset **plastike** jo ushqimore, të thata dhe të pastra;
- **Polystireni** i bardhë jo i ndyrë (mbetjet e ambalazheve të pajisjeve elektrike shtëpiake dhe pllakat izoluese);
- **Vajërat motorike** (maksimumi 10 litra në muaj), vajrat dhe yndyra e fërgimeve (maksimumi 5 litra ose 5 kg në javë);
- **P.M.C** : shishe e limunadave, të ujit, të prodhimeve të mirëmba jtjes, kanaqet, kutitë e konservave, enët dhe pjatat e alumimit, arkat për lëngje dhe ambalazhet e posaçme për lëngje, të zbrazëta dhe të shtypura, bombat aerosol pa kokë vdekjepurëse;
- **Gomat** tuaja pa ose me rreth metalik (maksimumi 4 për vizitë);
- **Qelqi**: shishe, shishe të vogla dhe bokaj të zbrazët, pa kapak dhe pa tape;
- **Rrobat tuaja** të pastra, në gjendje të mirë dhe të mbështjella në thasë të mbyllur;
- **Azbesti** ose çimentoja e kondicionuar, sipas indikacioneve të menaxherit të parqeve me kontejnerë.

PËR TË DITUR MË SHUMË SHIH:

www.environnement-namur.be

RIKUPERIMI, MËNYRA E PËRDORIMIT



Rikuperim do të thotë ripërdorim ose riparim i një prodhimi ose i një materie për ta përdorur sërish.

Po ashtu kjo do të thotë:

- Kursim i lëndëve të para dhe të energjisë;
- Zvogëlim i vëllimit të mbeturinave tona dhe njëkohësisht edhe zvogëlim i dëmeve;
- Mbështetja e punësimit lokal të krijuar nga ndërmarrjet që merren me mbledhjen, riparimin, rishpërndarjen ose me rishitjen e gjësendeve.

UNË MARR PJESË NË RIKUPERIM!

Para se ta hudsoni një send, bëjeni këtë pyetje:

«Ky send a mund të përdoret prapë ose a mund të jetë i dobishëm për njerëz të tjerë?»

■ Unë po ua jap edhe një jetë tjetër sendeve të mia

- Unë merrem me çdo punë, i rikuperoj, «i përshtat» sendet e mia dhe i riparoj;
- Unë pastroj, ngjyros, i gërryeyj mobilet e mia të vjetra ose i pikturoj ato;
- Unë i ndërroj butonat e prishur të sirtarëve, dorezat dhe dyert e tyre;
- Unë përdor efektet metalike aktuale. Rrjeta e hollë do ta zëvendësojë xhamin e thyer ose pasqyrën që mungon;
- Mendoj për plaçka të vjetra për ta zbrazur drithnikun tim. Doemos është një afër shtëpisë sime: Temploux, La Plante, Jambes...

■ Unë ua jap sendet e mia shoqatave lokale të cilat kujdesen t'ua gjejnë një pronar të ri.

■ Unë e thërras kompaninë Mobilier

Kompania Mobilier e qytetit Namur organizon mbledhjen nëpër shtëpi të mobilieve, enëve, pajisjeve elektrike, që janë kryesisht në gjendje të mirë. Ato pastaj u shiten me çmim të ulët familjeve që nuk i kanë këto sende ose familjeve me nevoja urgjente.

Tel: 081/248 596

■ Unë e thërras shërbimin për mbledhje falas të sendeve që bezdisin

La Ressourcerie Namuroise siguron grumbullimin nëpër shtëpi të sendeve në gjendje të mirë të cilat ju bezdisin. Ky është një sistem i thjeshtë dhe efikas.

Tel: 081/260.400

RIPËRDORIMI PO ASHTU, DO TË THOTË TË BLESHE NË NJË FORMË TJETËR

Pjesëmarrja në procesin e ripërdorimit do të thotë, po ashtu, të blesh sende që kanë një histori, një të kaluar. Mendoni për dyqanet e sendeve të përdorura dhe për Ravik Boutik:

Boulevard d'Herbatte 8- 5000 Namur

Nga e marta deri të shtunën prej orës 10⁰⁰ deri në ora 18⁰⁰

PËR TË DITUR MË SHUMË SHIH:

www.environnement-namur.be

MBLEDHJA E MBETURINAVE PARA DERËS SUAJ



PËR ÇDO LLOJ MBETURINASH, MBLEDHJE E VEÇANTË!

Ju lutemi që t'i respektoni gjithmonë udhëzimet e klasifikimit, ditët dhe kohën e mbledhjes. Për njerëzit që nuk i respektojnë këto udhëzime, janë paraparë dënime minimale prej 125 eurosh.

Kalendari i mbledhjes shpërndahet çdo vit në të gjitha kutitë në fund të vitit. Po ashtu kalendari është disponibël edhe me kërkesë në numrin 0800/935.62 (thirrje falas) si dhe në faqen e internetit: www.environnement-namur.be

MODALITETET PRAKTIKE

MBETURINAT SHTËPIAKE: në thasë mbeturinash të madhësisë 30 ose 60 litra

- Ëmbëlsirat e mbështjella me polystiren, gota jogurti, letra alumini;
- Salvetat higjienike, fasha, pambuk makijazhi, fije pambuku;
- Plastika ambalazhi (përveç shisheve dhe shishëzave plastike);
- Letrat dhe kartonët e ndyrë;
- Çdo mbeturinë që nuk është objekt i grumbullimit specifik.

MBETURINAT ORGANIKE: në thasë 25 litërsh që mund të dëmtohen nga organizmat e gjallë.

- Mbeturina ushqimore të ngurta pa ambalazh. Mbeturina nga shujtat, fruta, perime, gëzhoja vezësh, arrash, gocash deti, yndyrëra të fërgimeve të ngurta;
- Fletë dhe qeska çaji, filtra dhe fundaq kafeje;
- Faculeta dhe salveta letre, sfungjerë pastrimi;
- Mbeturina të gjelbra kopshti dhe të brendshme: lule, bimë, perime, mbeturina nga bari i kositur, dhe nga krasitja e gardheve;
- Ndrizat e fëmijëve (jo ndrizat e të rriturve).

LETRAT-KARTONËT: të lidhur me spango ose të mbështjella me një kuti kartoni të mbyllur.

- Ambalazhet e vërteta të letrës ose kartonit;
- Gazetat, revistat, shtypi publicitar;
- Vjetarët telefonikë;
- Zarfat pa kapak;
- Fotokopjet, letrat e kompjuterit.

P.M.C: në thasë të kaltër 60 litërsh.

- Shishe limunatash, uji ose lëngjesh, shishe dhe ambalazh prodhimesh për mirëmbajtje (për enë, zbutës), ambalazh prodhimesh për banjo ose për dush;
- Kanaçe, kuti konservash, enë dhe pjata alumini, kapsula dhe kapakë kavanozësh, bomba aerosol (pa kokë vdekjeprurëse);
- Tetra pak, tetra brik, ambalazhe speciale lëngjesh

Thasët dhe letër-kartonët duhet të deponohen në vigjillie të ditës së grumbullimit duke filluar nga ora 18 ose para orës 6 të mëngjesit ditën e grumbullimit.

PËR TË DITUR MË SHUMË SHIH:

www.environnement-namur.be